



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

19.09.2026

“Zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë profesionit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare.”

ALTERNATIVA (17 x 1 pikë)

1. Rretho alternativën e saktë: Cila nga pohimet e mëposhtme është i saktë lidhur me padinë për kërkimin e sendit?

- a. Ngrihet vetëm për të kundërshtuar vjedhjen e sendit;
- b. Një bashkëpronar ka të drejtë të ngrejë padinë për kërkimin e sendit për një send në bashkëpronësi me qëllim që sendi t’i kthehet atij;
- c. Është mjet për të kërkuar rivendosjen e posedimit mbi sendin nga pronari i ligjshëm i tij, i cili e ka humbur posedimin;
- d. Është e parashkrueshme me kalimin e 10 viteve;
- e. Mund të ngrihet vetëm kundër personave privatë.

Përgjigja e saktë është alternativa (c).

2. Rretho alternativën e saktë: Nuk është kusht i përgjegjësisë civile jashtëkontraktore:

- a. Ekzistenca e një dëmi të shkaktuar ndaj një personi tjetër;
- b. Ekzistenca e një veprimi ose mosveprimi të kundërligjshëm;
- c. Ekzistenca e fajit;
- d. Ekzistenca e një marrëdhënieje juridik kontraktore të vlefshme ndërmjet autorit të dëmit dhe të dëmtuarit;
- e. Ekzistenca e lidhjes shkakësore.

Përgjigja e saktë është alternativa (d).

3. Rretho alternativën e saktë: Në rastin e bashkëpronësisë?

- a. Tjetërsimi i pjesës takuese mbi sendin e njërit bashkëpronar tek një person i tretë bëhet vetëm me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve të tjerë;
- b. Tjetërsimi i pjesës takuese mbi sendin e njërit bashkëpronar tek një person i tretë mund të bëhet lirisht, pa pëlqimin e bashkëpronarëve të tjerë;
- c. Tjetërsimi i pjesës takuese mbi sendin e njërit bashkëpronar tek një person i tretë mund të bëhet me pëlqimin e shumicës së bashkëpronarëve të tjerë;
- d. Tjetërsimi i pjesës takuese mbi sendin e njërit bashkëpronar tek një person i tretë mund të bëhet lirisht pas respektimit të të drejtës së parablerjes;
- e. Tjetërsimi i pjesës takuese mbi sendin e njërit bashkëpronar tek një person i tretë mund të bëhet lirisht pas respektimit të të drejtës së parablerjes dhe me pëlqimin e shumicës së bashkëpronarëve të tjerë.

Përgjigja e saktë është alternativa (d).

4. Rretho alternativën e saktë: Cila është përmbajtja e institutit të begatimit pa shkak?

- a. Fitimi i pasurisë nëpërmjet trashëgimisë lind detyrimin për ta kthyer atë;
- b. Marrja e dhuratave mes të afërmeve, sjell detyrimin që në raste të caktuar ti kthesh përfitimet që ke marrë;
- c. Rritja e të ardhurave nga investimet lind detyrimin për ta kthyer pasurinë e shtuar;
- d. Çdo lloj kontrate e shitjes sjell kalimin e pronësisë duke lindur gjithashtu detyrimin për ta kthyer atë me kalimin e një afati;
- e. Shtimi apo kursimi i pasurisë së një personi në dëm të një tjetri, pa shkak të ligjshëm dhe pa faj, lind detyrimin për ta kthyer këtë pasuri të shtuar apo kursyer;

Përgjigja e saktë është alternativa (e).

5. Gjeni alternativën e saktë: Çfarë veprimi ndëshkohet penalisht sipas nenit 165 të Kodit Penal “Falsifikimi i nënshkrimeve”?

- a. Përdorimi i dokumenteve pa vulë;
- b. Shkatërrimi i dokumenteve zyrtare;
- c. Deklarimi i remë i derdhjeve të fondeve të shoqërisë;
- d. Mbajtja e mjeteve të falsifikimit pa i përdorur ato;
- e. Dhënia e të dhënave të pasakta në deklaratat tatimore;

Përgjigja e saktë është alternativa (c).

6. Gjeni alternativën e gabuar:

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për:

- a. ndryshimin e statutit;
- b. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- c. shpërndarjen e fitimeve;
- d. emërimin e administratorit;
- e. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Përgjigja e saktë është alternativa (d).

7. Shoqëria aksionare me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se:

- a. 2,000,000 lekë;
- b. 3,000,000 lekë;
- c. 3,500,000 lekë;
- d. 4,000,000 lekë;
- e. 10,000,000 lekë.

Përgjigja e saktë është alternativa (e).

8. Me përjashtim të rasteve kur padia ndaj shoqërisë kolektive ka një afat parashkrimi më të shkurtër, paditë ndaj një ortaku për detyrimet e shoqërisë kolektive ngrihen:

- a. brenda 6 muajve pas prishjes së saj;
- b. brenda 1 viti pas prishjes së saj;
- c. brenda 2 vjetëve pas prishjes së saj;
- d. brenda 3 vjetëve pas prishjes së saj;
- e. brenda 5 vjetëve pas prishjes së saj.

Përgjigja e saktë është alternativa (d).

9. Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është:

- a. Jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim dhe nuk përfshijnë ditët e festave zyrtare
- b. Jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim dhe përfshijnë ditët e festave zyrtare
- c. Jo më pak se 30 ditë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim dhe nuk përfshijnë ditët e festave zyrtare
- d. Jo më pak se 30 ditë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim dhe përfshijnë ditët e festave zyrtare
- e. asnjëra prej alternativave të mësipërme

Përgjigja e saktë është alternativa (e).

10. Cila nga alternativat e mëposhtme është jo e saktë?

Regjistrimi i subjekteve në regjistrin tregtar përbën, gjithashtu, regjistrimin e njëkohshëm të tyre pranë:

- a. administratës tatimore qendrore;
- b. administratës tatimore vendore;
- c. sigurimeve shoqërore e shëndetësore;
- d. qendrës kombëtare të licensimit apo inspektoriatit teknik të fushës;
- e. inspektoratit të punës.

Përgjigja e saktë është alternativa (d).

11. Në lidhje me Regjistrin e Pronarëve Përfitues cila nga pohimet e mëposhtme është i gabuar:

- a. Subjektet raportuese kanë detyrimin të ruajnë dhe të mbajnë të dhëna dhe dokumente shoqëruese të duhura, të sakta e të përditësuara, në bazë të të cilave përcaktohen pronarët përfitues të subjektit dhe lloji i kontrollit të pronarëve të tyre përfitues;
- b. Pronarët përfitues të subjekteve raportuese kanë detyrimin t'u japin subjekteve raportuese të gjithë informacionin e nevojshëm për regjistrim;
- c. Përditësimi apo ndryshimi i të dhënave të regjistruara në regjistër bëhet vetëm nga personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues;
- d. Regjistri i Pronarëve Përfitues administrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- e. Çdo person mund të marrë informacion për të dhënat e regjistruara në regjistër, të cilat nuk janë lirisht të aksesueshme dhe publike, vetëm nëse provon se ka një interes të ligjshëm për marrjen e këtij informacioni.

Përgjigja e saktë është alternativa (c).

12. Gjenerali alternativën e saktë për pohimin:

Në procesin e bashkimit apo ndarjes së një shoqërie ekspertët e pavarur të fushave të ndryshme duhet të hartojnë një raport ku duhet të vlerësojnë nëse raporti i këmbimit të kuotave/aksioneve është i drejtë dhe i arsyeshëm, duke mbajtur parasysh:

- a. për metodën ose metodat e përdorura për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve/kuotave;
- b. nëse kjo metodë apo këto metoda janë të përshtatshme për rastin në fjalë, duke treguar vlerat e arritura përmes përdorimit të metodës/metodave dhe të japin një mendim për rëndësinë relative të secilës metodë, për të arritur në vlerën e vendosur;
- c. në rastin e një zmadhimi kapitali, të kryer në kuadër të bashkimit apo ndarjes, me qëllim pagimin e aksionarëve të shoqërive që përthithen apo ndahen, raporti i vlerësimit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë, si dhe në të duhet të përcaktohen metodat e vlerësimit që janë zbatuar dhe të shprehet nëse vlera e llogaritur sipas kësaj metode i korrespondon të paktën vlerës nominale të aksionit dhe, kur është rasti, edhe primit më të lartë të emetimit të aksionit;
- d. ekspertët kanë të drejtë të marrin nga shoqëritë që bashkohen të gjithë informacionin dhe dokumentet përkatëse;
- e. të gjitha alternativat e mësipërme janë të sakta;

Përgjigja e saktë është alternativa (e).

13. Përgjegjësia e ekspertëve të pavarur, administratorëve apo anëtarëve të Këshillit të Administrimit apo Këshillit Mbikqyrës ndaj dëmeve të pësuar nga aksionerët gjatë bashkimit të shoqërive tregtare me përthithje:

- a. është solidare bashkë me shoqërinë përthithëse;
- b. është solidare me shoqërinë e përthitur;
- c. është solidare bashkë me shoqërinë përthithëse, me përjashtim të rasteve kur ata provojnë se i kanë përmbushur rregullisht detyrimet ligjore, të lidhura me vlerësimin e pasurive të shoqërive dhe me procedurat e përsosjes së marrëveshjes së bashkimit;
- d. nuk kanë përgjegjësi;
- e. parashkruhet brenda 10 viteve nga data e regjistrimit të bashkimit të shoqërive.

Përgjigja e saktë është alternativa (c).

14. Cili nga pohimet e mëposhtme është i gabuar në lidhje me natyrën e aksioneve në shoqërinë aksionare:

- a. një aksion i shoqërisë mund të zotërohet nga një apo më shumë persona;
- b. aksionet me përparësi mund të emetohen pa të drejta vote;
- c. aksionet me përparësi nuk mund të përfaqësojnë më shumë se 49 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- d. çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon ndryshe;
- e. lejohet emetimi i aksioneve, të cilat i japin zotëruesit të tyre më shumë të drejta vote, në raport me pjesën e kapitalit, që aksioni përfaqëson.

Përgjigja e saktë është alternativa (e).

15. Subjekteve u kërkohet t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore, në zbatim të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë:

- a. të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, vetëm nëse kryhen si një transaksion i vetëm;
- b. të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën
- c. të barabartë ose më të madhe se 2 000 000 (dy milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, vetëm nëse kryhen si një transaksion i vetëm;
- d. të barabartë ose më të madhe se 2 000 000 (dy milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën;
- e. të barabartë ose më të vogël se 2 000 000 (dy milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën

Përgjigja e saktë është alternativa (b).

16. Brenda sa ditëve ka të drejtë debitori të kundërshtojë me shkrim fillimin e procedurave të falimentimit, nga momenti kur është njoftuar për kërkesën e kreditorit:

- a. 30 ditëve;
- b. 60 ditëve;
- c. 15 ditëve;
- d. 10 ditëve;
- e. 7 ditëve.

Përgjigja e saktë është alternativa (d).

17. Cila nga alternativat e mëposhtme është e saktë në lidhje me vendimin e Gjykatës së falimentimit për përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive?

Gjykata e falimentimit vendos përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive nëse:

- a. nuk ka pasur kundërshtime për përfundimin e procedurës nga palët që mund të kundërshtojnë, pas kalimit të afatit 60-ditor;
- b. nuk ka pasur kundërshtime për përfundimin e procedurës nga palët që mund të kundërshtojnë, pas kalimit të afatit 30-ditor;
- c. kanë kaluar 30 ditë nga komunikimi që gjykata i bën prokurorit për pushimin e çështjes penale;
- d. Alternativat b) dhe c);
- e. Alternativat a), b) dhe c).

Përgjigja e saktë është alternativa (a).

PYETJE ME SHTJELLIM (5 x 4 pikë)

Pyetje 1:

Cilat janë kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe cili është kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje?

Përgjigje:

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet si vijon: a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; b) ndryshimet e statutit; c) emërimin e shkarkimin e administratorëve; ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç"; dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre; g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë; i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të thjeshtë, nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit nr.9901/2008 (për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë), ajo vendos me tri të katërtat e votave, kur marrin pjesë ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.

Pyetje 2:

Cilat janë kushtet dhe kufizimet e ndalimit të konkurrencës nga punëmarrësi, pas përfundimit të marrëdhënieve të punës?

Përgjigje:

Kushtet

Punëmarrësi mbi 18 vjeç mund të zotohet me shkrim kundrejt punëdhënësit që, pas përfundimit të marrëdhënieve të punës, nuk do t'i bëjë atij konkurrencë në asnjë lloj mënyre, veçanërisht, nuk do të formojë një sipërmarrje konkurrençe, nuk do të punojë dhe nuk do të interesohet për të.

Marrëveshja për ndalimin e konkurrencës është e vlefshme vetëm nëse raportet e punës i kanë dhënë mundësinë punëmarrësit të ketë dijeni për sekretet e fabrikimit ose të veprimtarisë së punëdhënësit dhe nëse përdorimi i këtyre sekreteve mund t'i shkaktojë punëdhënësit një dëm të rëndë.

Punëdhënësi mund të kërkojë zbatimin e marrëveshjes për ndalimin e konkurrencës vetëm nëse i ofron punëmarrësit, gjatë periudhës së ndalimit, jo më pak se 75 për qind të pagës që ai do të merrte po të vazhdonte të punonte për punëdhënësin. Kur paga është e ndryshueshme, shpërblimi llogaritet mbi bazën e pagës mesatare të vitit të mëparshëm dhe indeksohet.

Kufizimet

Marrëveshja duhet të përcaktojë qartë ndalimin e konkurrencës për vendin, kohën, llojin e veprimtarisë, për të mos dëmtuar të ardhmen ekonomike të punëmarrësit. Afati i ndalimit nuk mund të jetë më shumë se një vit.

Gjykata mund të zvogëlojë elementet e sipërpërmendura për ndalimin e konkurrencës së tepruar, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat. Ajo mban parasysh veçanërisht nëse shpërblimi i dhënë nga punëdhënësi tejkalon minimumin e parashikuar më sipër.

Pyetje 3:

Cilat janë pasojat e çregjistrimit nga regjistri tregtar për personat juridikë dhe fizikë?

Përgjigje:

Ç'regjistrimi i personave juridikë nga regjistri tregtar ka si pasojë humbjen e personalitetit juridik të subjekteve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme. Ç'regjistrimi nga regjistri tregtar i personave fizikë, degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja, shoqërive të thjeshta, sipas Kodit Civil, si dhe të subjekteve të tjera që, sipas legjislacionit në fuqi, nuk fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet regjistrimit, ka vetëm efekt deklarativ. Subjektet e çregjistruara përgjigjen për detyrimet e mbetura ndaj të tretëve dhe ndaj autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pyetje 4:

Cilat janë kategoritë e klientëve ndaj të cilëve zbatohet vigjilenca e zgjeruar në zbatim të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit?

Përgjigje:

Sipas neneve 7 dhe 8 të Ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, vigjilenca e zgjeruar zbatohet ndaj marrëdhënieve të biznesit, klientëve dhe transaksioneve që paraqesin rrezik të lartë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Përveç kategorive të përcaktuara shprehimisht nga ligji, subjektet duhet të identifikojnë dhe të përcaktojnë, në bazë të vlerësimit të riskut, edhe kategori të tjera klientësh, transaksionesh, produkteve, shërbimesh, kanalesh shpërndarjeje ose rreziqesh gjeografike me risk të lartë.

Në mënyrë të posaçme, neni 8 parashikon këto kategori:

1. **Personat e ekspozuar politikisht**, si dhe, sipas ligjit, anëtarët e familjes dhe personat e lidhur ngushtë me ta. Për këta klientë kërkohet, ndër të tjera, miratimi i drejtuesve të lartë për vendosjen ose vazhdimin e marrëdhënies së biznesit, marrja e masave të arsyeshme për përcaktimin e burimit të pasurisë dhe të fondeve dhe monitorimi i zgjeruar i marrëdhënies së biznesit.
2. **Organizatat jofitimprurëse**, ndaj të cilave subjektet duhet të mbledhin informacion të mjaftueshëm për burimet e financimit, natyrën e veprimtarisë dhe mënyrën e administrimit dhe drejtimit, të vlerësojnë reputacionin e tyre, të marrin miratimin e niveleve të larta të administrimit ose drejtimit dhe të kryejnë monitorim të zgjeruar të marrëdhënies së biznesit.
3. **Klientët jorezidentë, kur marrëdhënia e biznesit ose transaksionet e tyre vlerësohen me risk të lartë**. Kjo është një pikë e rëndësishme, pasi ligji aktual nuk e trajton më çdo klient jorezident automatikisht si kategori për vigjilencë të zgjeruar, por e lidh këtë detyrim me vlerësimin e riskut.
4. **Klientët që banojnë ose ushtrojnë veprimtarinë në vende për të cilat kërkohet marrja e masave të posaçme**, sipas përcaktimeve ose kërkesave të autoritetit përgjegjës. Në këto raste kërkohet analizimi i arsyeve dhe qëllimit të transaksioneve dhe, sipas rastit, marrja e masave shtesë të vigjilencës.

- 5. Klientët që janë organizime ligjore, si dhe shoqëritë që kanë aksione të mbajtësit,** përfshirë rastet kur këto organizime ose shoqëri janë pjesë e strukturës së pronësisë, kontrollit ose vendimmarrjes së klientit.

Përveç këtyre kategorive të klientëve, neni 8 parashikon edhe raste të tjera të detyrueshme të vigjilencës së zgjeruar, ndër të tjera për transaksione komplekse, me vlera të larta ose të pazakonta, pa një qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor, për klientë të kategorizuar me risk të lartë nga vetë subjekti, si dhe për klientë ose transaksione për të cilët autoriteti përgjegjës kërkon zbatimin e vigjilencës së zgjeruar.

Në përfundim, vigjilenca e zgjeruar nuk kufizohet vetëm në një listë formale klientësh. Ajo mbështetet në një qasje të bazuar në risk, ku subjektet duhet të identifikojnë, vlerësojnë dhe menaxhojnë në mënyrë të vazhdueshme rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Pyetje 5:

A zbatohet Ligji për Falimentimin në rast të paaftësisë paguese të një subjekti që ushtron veprimtarinë e tij në një sektor strategjik të përcaktuar me ligj të posaçëm?

Përgjigje:

Po. Ligji nr. 110/2016, “Për falimentimin”, mund të zbatohet edhe ndaj një subjekti që ushtron veprimtarinë në një sektor strategjik të përcaktuar me ligj të posaçëm ose që kryen një shërbim publik, por zbatimi i tij varet nga ekzistenca dhe përmbajtja e ligjit të posaçëm.

Sipas nenit 7, pika 5, të Ligjit për Falimentimin, në rast të paaftësisë paguese të një subjekti të tillë, Ligji për Falimentimin zbatohet:

- a) **kur veprimtaria nuk rregullohet nga një ligj i posaçëm; ose**
- b) **kur veprimtaria rregullohet me ligj të posaçëm, por subjektit i është hequr licenca.**

Pra, rregulli është se për subjektet që ushtrojnë veprimtari strategjike ose kryejnë shërbime publike, ligji i posaçëm ka përparësi në rregullimin e regjimit të paaftësisë paguese. Ligji i Falimentimit zbatohet në kushtet alternative të përcaktuara shprehimisht nga neni 7, pika 5.

Ky rregull duhet lexuar së bashku me pikën 4 të të njëjtit nen, sipas së cilës Ligji për Falimentimin nuk zbatohet për shoqëritë e sigurimit, bankat, fondet e pensioneve, fondet e investimeve dhe institucionet e tjera që grumbullojnë depozita nga publiku ose institucione të tjera financiare, kur procedura e falimentimit për to rregullohet me ligj të posaçëm. Për institucionet jobankare zbatohen rregullat përkatëse të legjislacionit bankar.

USHTRIME (9 x 7 pikë)

Ushtrimi 1

Shtetasi (A) është 20 vjeç dhe blen nga shtetasi (B), që është 40 vjeç, një shtëpi banimi një katëshe, për një shumë 5,000,000 lekë. Kontratën e shitjes e bëjnë me shkresë të thjeshtë, pa akt noterial dhe e nënshkruajnë të dy. Shtetasi (A) jeton në këtë shtëpi dhe e gëzon i qetë atë për 22 vjet, në mënyrë të pandërprerë. Pas 22 vitesh, shtetasi (B) vdes. Trashëgimtarët e tij kontaktojnë shtetasin (A) dhe i kërkojnë atij të lirojë shtëpinë, sepse ajo është pronë e babait të tyre të ndjerë dhe si e tillë ata janë pronaret e ligjshëm të saj për shkak të trashëgimisë. Shtetasi (A) u tregon pretenduesve kontratën e shitjes, që babai i tyre kishte nënshkruar para 22 vjetësh, por trashëgimtarët e kundërshtojnë duke pretenduar se: (1) ata nuk kanë lidhje me këtë kontratë sepse nuk është nënshkruar prej tyre, por prej babait të tyre; (2) kontrata është pa akt-noterial dhe nuk është e vlefshme.

Analizoni pretendimet e palëve sipas dispozitave të Kodit Civil dhe jepini përgjigje këtyre pyetjeve:

1. A kanë të drejtë trashëgimtarët e personit (B) për pretendimin nr.1 dhe pretendimin nr.2 të tyre ?
2. A mund të mbrohet personi (A) dhe a mund të fitojë ai pronësinë mbi objektin "shtëpi banimi" në kushtet e mësipërme? Nëse po, si mund ta bëjë ai këtë?

ZGJIDHJE

Baza ligjore: nenet 83, 92, 165, 168, 169, 170 dhe 193 të Kodit Civil.

1. Pretendimet e trashëgimtarëve

Pretendimi nr. 1, sipas të cilit trashëgimtarët nuk kanë lidhje me kontratën sepse ajo është nënshkruar nga babai i tyre dhe jo prej tyre, nuk mbështetet juridikisht. Trashëgimtarët hyjnë në pozitën juridike pasurore të trashëgimlënësit dhe fitojnë pronësinë me trashëgim mbi sendet dhe të drejtat e trashëgimlënësit, sipas nenit 316 të Kodit Civil, por vetëm për sendet dhe të drejtat që trashëgimlënësi kishte në çastin e çeljes së trashëgimisë, i cili është çasti kur vdes trashëgimlënësi (neni 318 i Kodit Civil). Ata nuk mund ta shpërfillin një veprim juridik (në rastin tonë një tjetërsim me shitje të sendit) të kryer nga vetë trashëgimlënësi, gjatë kohës që është gjallë, vetëm sepse nuk kanë qenë personalisht palë në marrëdhënien fillestare të shitjes. Nëse do të ishim në një situatë tjetër, kur shitja të ishte e rregullt (të ishte kryer me akt notarial), atëherë ky send (shtëpi banimi një katëshe) do të ishte në pronësi të blerësit dhe nuk do të ishte më në pronësi të trashëgimlënësit në momentin e vdekjes së tij dhe, për pasojë, nuk do të ishte send që kalonte me trashëgim tek trashëgimtarët.

Megjithatë, për kazusin tonë, kontrata me shkresë të thjeshtë nuk ka sjellë pasojë kalimin e pronësisë nga (B) tek (A). Sipas nenit 83 të Kodit Civil, veprimi juridik për kalimin e pronësisë së një sendi të paluajtshëm duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohët, përndryshe nuk është i vlefshëm. Në lidhje me nenin 92 të Kodit Civil, veprimi juridik i pavlefshëm (ky hyn dhe veprimi i cili vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit) nuk krijon pasojën juridike të synuar. Prandaj, vetëm nënshkrimi i shkresës së thjeshtë dhe dorëzimi faktik i shtëpisë nuk e kanë bërë (A)-në pronar dhe nuk ia kanë hequr automatikisht pronësinë (B)-së e për pasojë as trashëgimtarëve të tij, të cilët e fitojnë këtë send me trashëgim sepse sendi ka mbetur në pronësi të (B)-së deri në momentin e vdekjes së tij.

Për rrjedhojë, **pretendimi nr. 2 i trashëgimtarëve është i mbështetur ligjërisht** vetëm në pjesën ku ata pohojnë se kontrata, si kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme, nuk është e vlefshme për mungesë të formës noteriale dhe regjistrimit.

Por nga pavlefshmëria e kontratës nuk rrjedh se posedimi 22-vjeçar i (A)-së është pa pasoja. Ky posedim duhet të vlerësohet veçmas sipas rregullave të parashkrimit fitues.

2. Efekti i parashkrimit fitues dhe mbrojtja e personit A

Neni 168 i Kodit Civil parashikon se personi që ka fituar një send me mirëbesim, në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë që nuk është i ndaluar nga ligji, bëhet pronar pas posedimit të pandërprerë prej dhjetë vjetësh kur sendi është i paluajtshëm. Kur posedimi nuk është me mirëbesim, afati dyfishohet në njëzet vjet. Shkresa e thjeshtë e shitjes, ndonëse e pavlefshme për mungesë forme, evidenton marrëveshjen dhe shkakun e hyrjes së (A)-së në posedim; shitja si lloj veprimi juridik nuk është e ndaluar nga ligji. Nëse provohet mirëbesimi, afati dhjetëvjeçar është tejkaluar; edhe nëse mirëbesimi kundërshtohet, posedimi 22-vjeçar tejkalon afatin njëzetvjeçar.

Në mënyrë të pavarur, neni 169 i Kodit Civil përcakton se personi që ka poseduar qetësisht dhe pa ndërprerje një pasuri të paluajtshme, duke u sjellë sikur të ishte pronar për njëzet vjet, bëhet pronar i saj. Në kasus, (A) ka banuar dhe e ka gëzuar shtëpinë qetësisht, haptazi dhe pa ndërprerje për 22 vjet. Kështu, nëse provohet se gjatë gjithë kësaj kohe ai është sjellë si pronar dhe nuk ka pasur pezullim ose ndërprerje të afatit parashkrimit, plotësohen kushtet e nenit 169. Gjithashtu duhet të verifikohet se pasuria nuk është pronë publike e patjetërsueshme, e cila përjashtohet nga parashkrimi fitues sipas nenit 168.

Parashkrimi fitues është mënyrë origjinale e fitimit të pronësisë. E drejta e (A)-së nuk buron nga kontrata e shitjes, e cila është e pavlefshme, por nga posedimi i kualifikuar dhe kalimi i afatit ligjor. Me plotësimin e afatit, (A) fiton pronësinë, ndërsa e drejta e ish-pronarit shuhet për pasojë. Për këtë arsye, nëse afati ishte plotësuar para vdekjes së (B)-së, trashëgimtarët nuk mund të fitojnë me trashëgim një pronësi që trashëgimlënësi e kishte humbur tashmë nga parashkrimi fitues, edhe nëse pasuria vazhdon të figurojë formalisht e regjistruar në emrin e tij ose të trashëgimtarëve.

Sipas nenit 170 të Kodit Civil, (A) duhet të ngrejë padi për njohjen e pronësisë së fituar me parashkrim kundër personit pronar të mëparshëm ose, në rastin konkret, kundër trashëgimtarëve të tij që janë gjallë. Në gjykim duhet të provojë posedimin 22-vjeçar, posedimin e qetë dhe të vazhdueshëm, ushtrimin e pushtetit faktik si pronar, mungesën e ndërprerjes së afatit dhe identitetin e saktë të pasurisë. Shkresa (kontrata) e shitjes pa akt notarial mund të përdoret si provë e momentit dhe shkakut të fillimit të posedimit, por jo si titull i vlefshëm që ka kaluar pronësinë.

Pas njohjes së pronësisë me vendim gjyqësor të formës së prerë, (A) mund të kërkojë regjistrimin e pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Kjo rrjedh drejtpërdrejt nga neni 170 dhe nga neni 193, shkronja “dh”, i Kodit Civil, sipas të cilit regjistrohen vendimet gjyqësore që përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme.

Përfundimi i përmbledhur.

Trashëgimtarët nuk e kanë humbur pronësinë vetëm për shkak të kontratës së thjeshtë të nënshkruar nga (B), sepse ajo kontratë nuk e ka kaluar pronësinë. Megjithatë, (A) ka bazë të kërkojë njohjen e pronësisë me parashkrim fitues, pasi posedimi 22-vjeçar, sipas fakteve të kazusit, plotëson afatin e nenit 169 dhe tejkalon edhe afatin maksimal të nenit 168. Rruga juridike është padia kundër trashëgimtarëve sipas nenit 170 dhe, pas vendimit të formës së prerë, regjistrimi i pronësisë sipas nenit 193 të Kodit Civil.

Ushtrimi 2

Gjatë vitit 2011, një tregtar Shqiptar (Genti) zhvilloi aktivitetin e palicensuar të ndërmjetësimit për blerjen ose shitjen e letrave me vlerë/bono privatizimi. Në atë kohë, legjislacioni shqiptar nuk parashikonte rregullim specifik dhe as ndalim për këtë aktivitet. Me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një dispozitë të re në Kodin Penal, konkretisht Nenin 143/a/7, me emërtimin “*Tregtimi i paligjshëm i titujve*”, ku parashikohej se: “*Personi që merret me ndërmjetësim të paautorizuar për blerjen ose shitjen e titujve dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet*”. Ligji nr. 23/2012 hyri në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Prokuroria nisi ndjekje penale ndaj Gentit për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2011, duke pretenduar se ai kishte ushtruar aktivitet të paligjshëm dhe se ligji i ri kishte efekt prapaveprues, sepse kishte karakter shpjegues dhe sqarues të një ndalimi që kishte ekzistuar në mënyrë të nënkuptuar. Prokuroria e dërgoi dosjen e rastit në Gjykatë, duke kërkuar dënimin e Gentit.

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtëme:

1. A mund të dënohet penalisht Genti për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2011, kur nuk ekzistonte asnjë dispozitë ndaluese?
2. A ka ndonjë parim, apo dispozitë të Kodit Penal që e ndalon apo e lejon dënimin penal të Gentit.
3. Çfarë kuptoni me efekt prapaveprues (retroaktiv) të ligjit? A është i drejtë pretendimi i prokurorisë se ligji i ri penal ka efekt prapaveprues dhe se ndalimi ka ekzistuar edhe më parë në mënyrë “të nënkuptuar”?

ZGJIDHJE

1. Përgjegjësia për veprimtarinë e vitit 2011.

Genti nuk mund të dënohet penalisht për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2011. Në atë periudhë aktiviteti nuk ishte i ndaluar nga ligji dhe nuk parashikohej si vepër penale. Ligji i vitit 2012 solli një kriminalizim të ri, pra parashikoi një fakt penal dhe dënim penal të ri dhe si i tillë nuk mund të zbatohet përpara hyrjes së tij në fuqi.

2. Parimi i ligjshmërisë penale.

Neni 2, paragrafi.1, i Kodit Penal përcakton se askush nuk mund të dënohet për një vepër që nuk parashikohet shprehimisht me ligj si vepër penale. Sipas këtij paragrafi - **për t'u dënuar një person, sjellja e tij (veprimi apo mosveprimi) duhet të ketë qenë e parashikuar si vepër penale në kohën kur është kryer.**

3. Efekti prapaveprues dhe vlerësimi mbi pretendimin e Prokurorisë.

Efekti prapaveprues nënkupton zbatimin e një ligji për fakte të ndodhura përpara hyrjes së tij në fuqi. Ligji penal më i ashpër nuk ka efekt prapaveprues; Vetëm ligji më “i butë” (p.sh. dekriminalizimi ose ulja e dënimit) mund të zbatohet edhe për vepra të kryera më parë, para kohës së hyrjes së tij në fuqi. Në këtë rast, ligji i vitit 2012 është më “i ashpër”, sepse krijon vepër të re penale dhe vendos dënim të ri penal, prandaj nuk mund të zbatohet për veprimtari (fakte) të mëparshme. **Pretendimi i prokurorisë se ligji i ri (ligji i marsit 2012) kishte karakter shpjegues dhe sqarues të një ndalimi që kishte ekzistuar në mënyrë të nënkuptuar nuk qëndron**, sepse një ligj shpjegues interpreton një dispozitë ekzistuese, ndërsa këtu nuk kishte dispozitë të mëparshme për t'u sqaruar. Ligji i vitit 2012 ka karakter *krijues* dhe *tipizues* të një vepre të re penale. Gjithashtu **nuk mund të ketë ndalim apo vepër penale “të nënkuptuar”**, por ajo duhet të jetë e “shprehur” në ligj. Kështu dispozita e nenit 2 kërkon që ndalimi i faktit penal si *krim* ose *kundërvajje penale* duhet të parashikohet **shprehimisht** në ligj më parë, pra para se të jetë kryer veprimi që pretendohet të ndalohet dhe sanksionohet.

Përfundimi

Ndjekja penale ndaj Gentit për veprimtarinë e vitit 2011 cenon parimin e ligjshmërisë penale dhe duhet pushuar.

Ushtrimi 3

Në datën 05.07.2023, në mbledhjen e asamblesë së ortakëve, vendoset që shoqëria të shpërndajë fitimin ortakëve të saj, pasi administratori ka lëshuar certifikatën e aftësisë paguese të shoqërisë. Në mbledhje është konstatuar se aktivet likuide të saj nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet që bëhen të kërkueshme në 12 muajt në vazhdim. Në datë 10.07.2023, vijohet me shpërndarjen e fitimit ndaj ortakëve të shoqërisë. Argumentoni nëse shpërndarja e fitimit është në përputhje me dispozitat ligjore dhe përgjegjësitë e mundshme të administratorit dhe ortakëve të shoqërisë.

ZGJIDHJE

Shpërndarja e fitimit nuk është në përputhje me dispozitat ligjore pasi shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Duke qënë se shoqëria nuk ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim, nuk duhet të shpërndahej fitim për ortakët.

Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë. Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Duke qënë se administratori ka lëshuar certifikatë të pasaktë të aftësisë pague, ai përgjigjet personalisht para shoqërisë për kthimin e këtyre dividendëve.

Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë pague të shoqërisë.

Në rastin konkret, në mbledhjen e asamblesë së ortakëve është konstatuar se aktivet likuide të saj nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet që bëhen të kërkueshme në 12 muajt në vazhdim, pra ortakët kanë patur dijeni dhe për këtë shkak duhet të kthejnë dividendët e marrë.

Ushtrimi 4

Ndodh që gjatë veprimtarisë tregtare të një shoqërie, personi përgjegjës për administrimin e saj nuk u jep informacionin e kërkuar ortakëve të shoqërisë. Përcaktoni nëse dhe kur kjo kërkesë e ortakëve vlerësohet si refuzim dhe veprimet e mëtejshme që mund të marrin ortakët në lidhje me këtë kërkesë.

ZGJIDHJE

Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë, i vënë ortakëve në dispozicion për shqyrtim pranë zyrës qendrore të shoqërisë tregtare informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nga këta të fundit, ose duke e vendosur këtë informacion në faqen e internetit të shoqërisë tregtare.

Nëse personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë nuk japin informacionin e kërkuar, ortakët, brenda 30 ditëve pas refuzimit, mund t'i kërkojnë gjykatës të urdhërojnë përmbaruesit gjyqësorë të ekzekutojnë kërkesën e ortakut apo aksionarit, duke i dorëzuar këtyre të fundit informacionin dhe dokumentet që personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë nuk kanë dhënë. Mosdhënia e informacioneve të kërkuara brenda 7 ditëve nga data e marrjes dijeni për kërkesën, vlerësohet refuzim.

Ushtrimi 5

Punëdhënësi I.I. dhe punëmarrësi T.N. lidhin një kontratë punësimi, ku paga llogaritet me ditë dhe janë përcaktuar këto rregulla:

- i punësuari do paguhet në monedhën euro;
- i punësuari do e marrë pagën në cash;
- nga paga do i zbritet tatimi mbi të ardhurat dhe kontributi i sigurimeve shoqërore, shëndetësore të parashikuara me ligj;
- paga do paguhet një herë në muaj;
- i punësuari do të marrë dhe pagë në natyrë në masën 30 përqind të pagës mujore

Argumentoni ligjshmërinë e kushteve të mësipërme.

ZGJIDHJE

- Paga mund të llogaritet me ditë, pasi paga mund të përlllogaritet në kohë.
- Me marrëveshje midis palëve, paga mund të paguhet me monedhën euro.
- Paga nuk mund të merret cash, pasi paga jepet vetëm nëpërmjet sistemit bankar.
- Punëdhënësi zbret nga paga e punëmarrësit tatimin mbi të ardhurat dhe kontributin e sigurimeve shoqërore shëndetësore
- Duke qënë se palët kanë rënë dakord me shkrim, paga lejohet të paguhet një herë në muaj, por nëse nuk ka marrëveshje, paga që llogaritet në bazë të ditëve, duhet të paguhet çdo dy javë.
- Përveç pagës në vlerë, punëmarrësi mund të përfitojë pagë në natyrë, por shuma mujore e pagës në natyrë nuk duhet të tejkalojë 20 përqind të pagës mujore.

Ushtrimi 6

Shoqëria italiane A srl, shtetasi italian B dhe shtetasi italian C bien dakord për të themeluar shoqërinë X SHPK me kapital 100 lekë në Shqipëri, ku A srl zotëron 25% të kapitalit, B zotëron 45% të kapitalit dhe C zotëron 30% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë. Shoqëria A srl zotërohet nga ortakut AA, i cili ka 10% të kuotave në këtë shoqëri, ortakut BB, i cili zotëron 70% të kuotave në shoqëri dhe ortakut CC, i cili zotëron 20% të kuotave në shoqëri. Ortaku CC shet kuotat e tij në shoqërinë A srl një personi të tretë.

- A ka detyrim ligjor shoqëria X SHPK të regjistrojë në regjistrin e pronarëve përfitues ortakët e saj? Pse?
- Cilët persona ka detyrimin ligjor të regjistrojë shoqëria X SHPK në regjistrin e pronarëve përfitues dhe pse.

ZGJIDHJE

Shoqëria X SHPK, si person juridik i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ka detyrimin të regjistrojë në Regjistrin e Pronarëve Përfitues personat fizikë që zotërojnë ose kontrollojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, shoqërinë. Në këtë regjistër nuk regjistrohen automatikisht të gjithë ortakët, por vetëm personat fizikë që plotësojnë kriteret për t'u konsideruar pronarë përfitues.

Në rastin konkret, B dhe C janë pronarë përfitues të drejtpërdrejtë, pasi zotërojnë përkatësisht 45% dhe 30% të kapitalit të X SHPK. Ndërsa A srl, megjithëse zotëron 25% të kapitalit të X SHPK, është person juridik dhe për këtë arsye duhet të identifikohet personi fizik që ushtron kontrollin përfundimtar mbi të. Meqenëse BB zotëron 70% të A srl, ai ushtron kontroll mbi këtë shoqëri dhe, nëpërmjet saj, konsiderohet pronar përfitues indirekt i X SHPK.

AA me 10% dhe CC me 20% të A srl nuk rezultojnë të kenë kontroll mbi këtë shoqëri, ndaj nuk konsiderohen pronarë përfitues të X SHPK. Edhe shitja nga CC e kuotës së tij prej 20% një personi të tretë nuk e ndryshon këtë situatë, për sa kohë BB vazhdon të zotërojë 70% dhe të ushtojë kontroll mbi A srl.

Për rrjedhojë, X SHPK duhet të regjistrojë si pronarë përfitues B, C dhe BB: B dhe C për shkak të pronësisë së drejtpërdrejtë dhe BB për shkak të kontrollit indirekt nëpërmjet A srl.

Ushtrimi 7

Shoqëria aksionare me ofertë publike X ka një sistem qeverisje me një nivel. Një anëtar i pavarur i Këshillit të Administrimit lidh një kontratë shitblerje me shoqërinë X.

Që ky veprim juridik të jetë i vlefshëm, i ligjshëm dhe të shmangen dëmet ndaj shoqërisë, cilat janë hapat që duhen ndërmarrë nga organet e shoqërisë X?

ZGJIDHJE

Neni 13. 2 -deklarohen kushtet e veprimit, natyra dhe objekti i interesit të personit anëtar i pavarur dhe veprimi autorizohet paraprakisht prej Këshillit të Administrimit. Miratimi paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet në QKB për regjistrim.

Në rastin konkret kemi një konflikt interesi, pasi anëtari i Këshillit të Administrimit është vetë palë në kontratën me shoqërinë X. Për këtë arsye, ai duhet të deklarojë interesin e tij dhe të mos marrë pjesë në vendimmarrjen për këtë kontratë.

Neni 13.4 - Anëtari me interes nuk voton dhe nuk llogaritet ne kuorum.

Neni 13.5 - Këshilli administrimit duhet që pa vonesë – jo më vonë se 72 orë - ta dërgojë veprimin që ka miratuar – aktin e miratimit – në asamblenë e përgjithshme. Brenda këtij afati duhet të publikohet dhe në faqen e internetit të shoqërisë. Brenda 6 muajve Asambleja e Përgjithshme mund të kërkojë në gjykatë shpalljen e pavlefshme të veprimit juridik të miratuar nga Këshilli i Administrimit, kur ky miratim është dhënë në shkelje të rëndë të ligjit apo Statutit.

Neni 13.6 - Veprimet që kërkojnë miratim duhet të publikohen në pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë.

Ushtrimi 8

Shoqëria aksionere X e cila është shoqëri shtetërore sipas kuptimit të ligjit 9901/2008 i ndryshuar përpara se të shesë 80% të aksioneve të saj ndaj të tretëve kryen ndryshime statutores duke parashikuar në statut se mbajtësi i aksioneve që shpreh të paktën 15% mund të ketë të drejtën e vetos mbi çdo vendim të asamblesë së përgjithshme për sa kohë bie ndesh me një interes publik?

A është e vlefshme kjo dispozitë në legjislacionin shqiptar dhe si duhet të rregullohen shoqëritë shtetërore?

ZGJIDHJE

Kjo dispozitë statutores nuk është e vlefshme. Ligji nr. 9901/2008 parashikon se shoqëria shtetërore është shoqëri tregtare që ushtron veprimtari me interes të përgjithshëm ekonomik dhe aksionet e së cilës zotërohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga pushteti qendror ose vendor. Themelimi, organizimi dhe funksionimi i saj u nënshtrohen dispozitave të ligjit nr. 9901/2008.

Në rastin konkret, pas shitjes së 80% të aksioneve, shteti mbetet me vetëm 20%. Ai nuk mund të ruajë përmes statutit një të drejtë të posaçme vetoje mbi çdo vendim të Asamblesë vetëm me arsyetimin se vendimi bie ndesh me interesin publik, sepse kjo do t'i jepte aksionarit shtetëror të drejta vendimmarrëse të privileguara që nuk burojnë nga rregullat e zakonshme të qeverisjes së shoqërisë.

Ushtrimi 9

Debitori A – qiramarrës, për shkak të përkeqësimit të gjendjes pasurore, nuk arrin të paguajë qiranë e ambjenteve ku ushtron veprimtarinë. Me fillimin e procedurës së falimentimit mospagesa e qirasë vijon edhe për dy muaj të tjerë dhe qiradhënësi njofton ndërprerjen e kontratës së qirasë.

Ky njoftim i ndërprerjes së kontratës së qirasë kundërshtohet si i papajtueshëm me ndalimin e parashikuar në Ligjin për falimentimin.

A është i bazuar në ligj një kundërshtim i tillë? A është i drejtë vendimi për ta zgjidhur kontratën e qirasë në këtë rast?

ZGJIDHJE

Kundërshtimi nuk është i bazuar në ligj. Vendimi i qiradhënësit për zgjidhjen e kontratës së qirasë, në rrethanat e paraqitura në ushtrim, është në përputhje me Ligjin nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

Neni 75 i këtij ligji vendos një mbrojtje të posaçme për kontratën e qirasë në interes të masës së falimentimit. Sipas pikës 1 të këtij neni, kontrata e qirasë, ku debitori është qiramarrës, nuk mund të zgjidhet nga qiradhënësi, pasi është kërkuar fillimi i procedurës së falimentimit, për shkak të:

a) mospagimit të qirasë përpara fillimit të procedurës së falimentimit; ose

b) përkeqësimit të gjendjes pasurore të debitorit.

Kjo dispozitë synon të pengojë që fillimi i procedurës së falimentimit, në vetvete, të përdoret si shkak për zgjidhjen e kontratës së qirasë dhe për largimin e debitorit nga ambientet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë.

Megjithatë, mbrojtja e parashikuar nga neni 75 nuk mbulon mospërbushjen e detyrimeve që lindin **pas fillimit të procedurës së falimentimit**. Pika 2 e nenit 75 përcakton se detyrimet e qirasë të lindura pas fillimit të procedurës konsiderohen shpenzime administrative. Në mënyrë të shprehur, e njëjta dispozitë parashikon se **mospërbushja e detyrimit të qirasë pas fillimit të procedurës i jep të drejtë qiradhënësit të zgjidhë kontratën**.

Në rastin konkret, debitori nuk ka paguar qiranë edhe për dy muaj pas fillimit të procedurës së falimentimit. Këto detyrime kanë lindur pas fillimit të procedurës dhe, për këtë arsye, nuk përbëjnë pretendime të zakonshme falimentimi, por detyrime që trajtohen si shpenzime administrative të procedurës.

Për rrjedhojë, ndalimi i parashikuar në nenin 75, pika 1, nuk mund të përdoret nga debitori për të kundërshtuar zgjidhjen e kontratës. Përkundrazi, neni 75, pika 2, i njeh shprehimisht qiradhënësit të drejtën për zgjidhjen e kontratës për shkak të mospërbushjes së detyrimit të qirasë të lindur pas fillimit të procedurës së falimentimit.

Përfundim: kundërshtimi i debitorit nuk është i bazuar në ligj. Në kushtet e ushtrimit, vendimi i qiradhënësit për zgjidhjen e kontratës së qirasë është i ligjshëm, pasi shkak i zgjidhjes është një mospërbushje e ndodhur pas fillimit të procedurës së falimentimit dhe jo mospagimi i një detyrimi të lindur përpara saj.